Ballkani Perëndimor GEFF II – KEP

Vendi:	KOSOVË
Numri i projektit:	53324
Sektori i biznesit:	Kredi jo depozituese (Jo bankare)
Lloji i njoftimit:	PRIVAT
Kategoria mjedisore:	FI
Data e aprovimit:	14 dhjetor 2021
Statusi:	E aprovuar
PSD e shpalosur në gjuhën Angleze:	10 dhjetor 2021

Përshkrimi i projektit

Kredi e pasigurar e nivelit të lartë deri në 3 milionë euro për KEP Trust (KEP) në tre këste të barabarta në kuadër të Mjetit Financues të Ekonomisë së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor II (WB GEFF II).

Objektivat e projektit

Mjeti do të mbështesë investimet në teknologjitë, materialet dhe solucionet e gjelbra me performancë të lartë, të ndërmarra në banesa ose ndërtesa banimi në pronësi private. Nën projektet do të përzgjidhen sipas kritereve të pranueshmërisë teknike dhe financiare të përcaktuara në Deklaratën e Politikës për WB GEFF II. Një qind për qind (100%) e përdorimit të të ardhurave do të kenë të bëjnë me investimet në Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër.

Ndikimi i tranzicionit

ETI 80

Projekti i kontribuon objektivave të përgjithshme të WB GEFF II, që mbështet cilësinë *e gjelbër* dhe *konkurruese* të TI.

E gjelbër: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie të gjelbër duke lehtësuar zgjerimin e dhënies së kredive për investime në teknologjitë e ekonomisë së gjelbër rezidenciale me performancë të lartë.

Konkurruese: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një sektori financiar më konkurrues duke ngritur kapacitetin e Institucioneve Financiare Partnere (IFP) për financimin e projekteve me ekonomi të gjelbër.

Informacion për klientin

KEP TRUST
KEP është institucioni më i madh mikrofinanciar në Kosovë, i themeluar si Organizatë Joqeveritare. KEP u themelua në gusht të vitit 1999 nga organizata humanitare zvicerane International Catholic Migration Commision (Komisioni Ndërkombëtar Katolik i Migracionit) dhe nga Klubi i Biznesit të Prizrenit. KEP i shërben rreth 23 mijë klientëve në të gjithë vendin me 31 degë të saja dhe me 244 punonjës.

Përmbledhja financiare e BERZH

3,000,000.00 Euro

Kostoja totale e projektit

3,000,000.00 Euro

Përmbledhja mjedisore dhe sociale

FI e kategorizuar (2019 ESP). KEP është një klient ekzistues dhe, gjer më sot, ka ofruar raporte të kënaqshme vjetore E&S për Bankën. KEP-it do t'i kërkohet të vazhdojë me zbatimin e procedurës për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe social për mikro kreditë, NVM dhe korporatat si dhe kriteret e pranueshmërisë specifike, mjedisore dhe sociale për projektet e energjisë së rinovueshme siç janë të aplikueshme. KEP-it do t'i kërkohet që të vazhdojë të jetë në përputhje me Kërkesat e Performancës (KP) të BERZH-it 2, 4 dhe 9, duke përfshirë respektimin e listës së zgjeruar të Përjashtimit të E&S BERZH dhe Listës së Referimeve të paraqitur me ESP 2019 dhe t'i dorëzoj Raportet Vjetore të E&S në Bankë. Nën-huamarrësve, të financuar nëpërmjet kredisë së KEP, do t'u kërkohet të jenë në përputhje me kërkesat nacionale, mjedisore, të shëndetit, sigurisë dhe punës (EHSL).

Investimet potenciale në energjinë e rinovueshme nën kornizën e GEFF do të duhet të ndjekin kriteret e pranueshmërisë së E&S për investime të tilla (solare, me erë, gjeotermale, me bioenergji ose me hidro central, sipas rastit). Përdorimi aktual i të ardhurave nga projekti mund të përfshijë nënprojektet solare. Nënprojektet e tilla do të menaxhohen në përputhje me 'Qasjen e Propozuar të Menaxhimit për Menaxhimin e Rrezikut të Zinxhirit Furnizues Solar' (CS/FO/21-35) dhe me çdo udhëzim pasues që zhvillohet sipas kësaj qasjeje.

Asistenca teknike

AT: 2,965 milionë euro janë dhënë për mbështetjen e AT në nivel të mjetit. AT është thelbësor për mbështetjen e përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të mjetit. Mjetet për AT për transaksionin e propozuar jepet nga Fondi Special i Aksionarëve (SSF) të BERZH-it dhe nga Qeveria e Austrisë.

Grante: 0.6 milionë euro (për këtë projekt) për stimujt e investimit për nën-huamarrësit për zbatimin e nën-projekteve të pranueshme në përputhje me Deklaratën e Politikës. Fondet e grantit sigurohen nga Bashkimi Evropian përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Projekti AT me Departamentin e BERZH-it, Këshilla për Biznesin e Vogël (ASB): Si një projekt i veçantë, KEP pritet të marrë asistencë në formë granti deri në 16 mijë euro nga ASB për t'a mbështetur KEP me zbatimin e strategjisë së tyre të re dixhitale.

Plotësimi:

Plotësimi arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë nëpërmjet KEP me AT dhe stimujt e investimeve në një pako që promovon investimet e ekonomisë së gjelbër rezidenciale në Kosovë.

Informacioni kontaktues i Kompanisë

Shpend Nura
shnura@keponline.net
+383 38 245 011
https://keptrust.org/

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.